

PROCESVERBAL

Sot, më datë 30.05.2019, në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë, u organizua takimi vijues me kryetarët e shoqatave të kineastëve. Në takim morën pjesë:

Z. Esat Ibro,

Z. Artan Maku,

Z. Ndriçim Xhepa,

Z. Dritan Huqi,

Znj. Sabina Kodra,

Z. Eno Milkani,

Z. Pluton Vasi,

Z. Jonid Jorgji.

Qendra Kombëtare e Kinematografisë përfaqësohej nga:

Z. Eduart Makri, Kryetar;

Z. Arben Lami, Drejtor i Drejtorisë së Projekteve;

Znj. Shqiponja Dauti, Juriste.

Takimi filloi me diskutimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 27 Maj 2019.

Më pas u diskutua lidhur me formulën e ngritjes së KMP, si dhe kriteret e përzgjedhjes së anëtarëve të KMP.

Pas diskutimeve, pjesëmarrësit në takim ranë dakort sa më poshtë:

1. Këshilli i Miratimit të Projekteve të filmit artistik dhe dokumentar të ketë këtë strukturë:

a- 3 (tre) anëtarë/anëtare me shtetësi të huaj, nga të cilët njëri të jetë me kombësi shqiptare;

b- 2 (dy) anëtarë/anëtare me shtetësi shqiptare.

a/1. Anëtarët/anëtaret me shtetësi të huaj të plotësojnë këto kritere:

- 1 (një) anëtar/anëtare i cili të jetë Regjisor, Producent;
- 2 (dy) anëtarë/anëtare, të ciët duhet të jenë Skenaristë.

b/2. Anëtarët/anëtaret me shtetësi shqiptare të plotësojnë këto kritere:

- 1 (një) anëtar/anëtare të jetë Regjisor;
- 1 anëtar/anëtare të jetë Producent.

2. Kriteret për t'u përzgjedhur si anëtar i KMP-ve:

- Të ketë realizuar jo më pak se tre filma artistikë, nga të cilët një të jetë pranuar në konkurim zyrtar në një festival kompetitiv (kategoria A);
- Të kenë mos kenë precedentë penalë, apo civilë;
- Të kenë një figurë të pastër etike.

3. Pas procesit të aplikimit, do të përzgjidhen në bazë të kriterëve 10 (dhjetë) kandidatura me shtetësi të huaj dhe 10 (dhjetë) kandidatura me shtetësi shqiptare.


4. Shoqatat e kineastëve do të përzgjedhin 3 (tre) anëtarë me shtetësi të huaj (njëri të jetë me kombësi shqiptare) dhe 2 (dy) anëtarë me shtetësi shqiptare.


5. Kjo formulë e KMP do të bëhet funksionale, në rast se Vendimi i Këshillit të Ministrave që përcakton masën e shpërblimit të anëtarëve të KMP-ve do jetë ndryshuar deri në datën 30.09.2019.

6. Në rast se nuk arrihet plotësimi i afatit të përcaktuar në pikën 5 të këtij procesverbali, do të vazhdojë funksionimi i KMP-ve sipas precedentëve të mëparshëm, në zbatim të ligjit nr. 8096, datë 21.03.1996, "Për kinematografinë", të ndryshuar. Anëtarët e KMP do të merren nga procedura e përcaktuar më lart.

7. Këshilli i Miratimit të Projekteve të filmave të animuar, për specifikën që ka, do të krijohet mbi bazën e kriterëve të njëjta. Specifikat e anëtarëve të KMP do të dërgohen me shkrim në një dokument të veçantë, nga Kryetari i Shoqatës “Albanimation”, z. Artan Maku.

Esat Ibro 

Artan Maku 

Ndriçim Xhepa 


Dritan Huqi 

Sabina Kodra 

Eno Milkani 

Pluton Vasi 

Jonid Jorgji 

Eduart Makri 

Arben Lami 

Shqiponja Dauti 

Ky procesverbal nënshkruhet në 2 kopje origjinale.